

2333



Res Publica &lt;qendra.respublica@gmail.com&gt;

## Kerkese per informacion Nr. Prot 163/23

Koordinatori Informimi &lt;Koordinatori.Informimi@drejtesia.gov.al&gt;

Mon, Nov 13, 2023 at 8:46 AM

To: Res Publica &lt;qendra.respublica@gmail.com&gt;

Përshëndetje,

Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar në rrugë elektronike përmes e-mailit [koordinatori.informimi@drejtesia.gov.al](mailto:koordinatori.informimi@drejtesia.gov.al) pranë Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkesën për dhënie informacioni, regjistruar me numër rendor 112 datë 07.11.2023.

Pas shqyrtimit të kërkesës, më poshtë gjeni përgjigjen nga struktura përkatëse pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit është dhe ushtron aktivitetin e saj në zbatim të vendimit Nr. 618, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit", i ndryshuar dhe ka si mision kryerjen e verifikimit/hetimit administrativ të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimin i punonjësve të institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimin e projekteve dhe të programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimin, koordinimin e përcaktimin e instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se për vitin 2022, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit nuk janë depozituar kallëzime penale në fushën e prokurimeve.

Duke Ju falenderuar

**Roland Stafa****Koordinatori për të drejtën e informimit****Ministria e Drejtësisë****Adresa: Bulevardi "Zog I-rë"****Tel: +355 4 2259-388/89/30/91/92/93 Ext: 711-00****E-mail: [Koordinatori.Informimi@drejtesia.gov.al](mailto:Koordinatori.Informimi@drejtesia.gov.al)****From:** Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>**Sent:** Tuesday, November 7, 2023 15:56**To:** Koordinator Informimi <Koordinatori.Informimi@drejtesia.gov.al>**Subject:** Kerkese per informacion Nr. Prot 163/23

**KUJDES:** Ky është një email i ardhur nga jashtë adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-të ose bashkëlidhjet nëse nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni dërguesit.

Përshëndetje!

[Quoted text hidden]

[Quoted text hidden]